



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:264192

Datë: 06.09.2024

Numri i dokumentit: 06220863

KA.nr. 86/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “N.T.P.T. “Renesansa” (H.P. B.I.) me NUI 810292665 dhe seli në fshatin Bajë e Pejës në komunën e Istogut, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Bardh Ademaj me seli në rrugën Garibaldi ½ në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, objekti i kontestit anulimi i aktit administrativ dhe shpërblimi i dëmit, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 02.09.2024, në të cilët morën pjesë përfaqësuesit e palëve, më 06.09.2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “N.T.P.T. “Renesansa” (H.P. B.I.) me NUI 810292665 kundër të paditurit Ministria e Infrastrukturës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër të protokollit 109 të datës 04.01.2019 të së paditurit, si dhe shpërblimin e dëmit material në lartësi prej 36,195.00€ në kamatëvonesë vjetore prej 8% nga data 27.12.2018.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet procedurale lidhur me këtë procedurë të konfliktit administrativ.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi më 27.12.2018 ka parashtruar padi kundër të Paditurit, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumës prej 36,195.00€ për shkak të dëmit të shkaktuar në emër të fitimit të humbur me kamatë prej 8% nga data e dorëzimit të padisë. Gjykata duke i zbatuar udhëzimet e Dhomës së Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, të dhëna në aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 632/23 të datës 08.02.2024, e ftoi Paditësin që të deklarohej

se a është i kënaqur me vendimin me numër të protokollit 109 të datës 04.01.2019 të së Paditurit, të cilin ky i fundit e kishte nxjerrë pasi ishte parashtruar padia, apo heq derë nga padia tërësisht ose pjesërisht, apo e zgjeron padinë edhe ndaj atij aktit administrativ. Padiësi përmes parashtrësës së datës 26.07.2024 e ka njoftuar gjykatës se, nuk është i kënaqur me aktin administrativ të cekur më lart, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.09.2024 ka deklaruar se kërkon anulimin e vendimit me numër të protokollit 109 të datës 04.01.2019 të së paditurit, si dhe shpërblimin e dëmit material në lartësi prej 36,195.00€ në kamatëvonesë vjetore prej 8% nga data 27.12.2018. Në të njëjtën seancë gjykata e lejoi ndryshimin e padisë, rrjedhimisht si objekt të shqyrtimit ishin kërkesat e Padiësit, të paraqitura dhe të lejuara gjatë seancës së datës 02.09.2024 (si më lartë).

2. Padiësi në padinë e tij ka pretenduar se, fillimisht lidhur me këtë çështje kishte ushtruar padi me datë 09.12.2013 për anulimin e vendimit nr. 3187 të datës 01.11.2013, të cilin Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative përmes aktgjykimit A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016 e kishte anuluar dhe çështja e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te i Padituri. Në këtë drejtim ka shtuar se, pranimit të aktgjykimit, i ishte drejtuar me kërkesë të Padituri për vendosje, të cilën as pas kërkesës së përsëritur nuk kishin vendosur, rrjedhimisht kishte ushtruar padi për shkak të heshtjes administrative. Më tutje kishte theksuar se, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative përmes aktgjykimit A.nr. 91/2017 e kishte aprovuar kërkesëpadinë e tij dhe kishte detyruar të Paditurin që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit të nxjerrë aktin administrativ në ri-vendosje sipas kërkesës së tij. Padiësi gjithashtu ka shtuar se, pas pranimit të atij aktgjykimit, përsëri i është drejtuar me parashtrësë të Paditurit me datë 10.12.2018, por i Padituri përsëri nuk ka nxjerrë vendimin, rrjedhimisht ka ushtruar padinë me kërkesë që Padiësit t'i kompensohet dëmi i shkaktuar për shkak revokimit të rendit të udhëtimit.
3. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesore ka deklaruar se vendimin i goditur është i kundërligjshëm, pasi edhe në procedurën e mëparshme lidhur me anulimin e vendimit, vendimi i atëhershëm është anuluar dhe është bërë i plotfuqishëm. Gjithashtu ka deklaruar se, është i kënaqur me ekspertizën nga eksperti A.B. të datës 01.04.2022 dhe nuk kërkon që ajo të përsëritet e as të dëgjohet eksperti. Përfundimisht kishte deklaruar se në këtë procedurë është vërtetua drejtë se nga i Padituri janë bërë shkelje për linjat e

kontraktuara, për çka edhe më parë është vendosur në procedurë nga i Paditura janë bërë shkelje të rënda.

4. I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë, duke theksuar se vendimi i kontestuar është nxjerrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa Paditësi nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij me asnjë provë. Në seancat e shqyrtimit kryesor ka shtuar se, përmes provave të lëndës vërtetohet se Inspektorati i Transportit Rrugor ka vepruar drejtë së bashku me komisionin e Ministrisë së Infrastrukturës ku ka revokuar vendin e udhëtimit. Në këtë drejtim ka shtuar se, vendimi i marr nga Komisioni i Ankesave dhe sekretarit të përgjithshëm të ministrisë është i drejtë dhe i bazuar me Ligjin për Transportin Rrugor 04/L-149 dhe UA 03/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër urban të udhëtarëve me autobus. Lidhur me ekspertizën ka deklaruar se, meqenëse e kundërshton kërkesëpadinë si të pabazuar, atëherë nuk kërkon që ekspertiza të përsëritet e as të dëgjohet eksperti.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi ref.3187 i datës 01.11.2013 i të paditurit; aktgjykimi A.nr.91/2017 i datës 31.10.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative; parashtresa e datës 23.12.2016 e paditësit e protokolluar te i padituri me numrin 6923; parashtresa e datës 10.12.2012 e paditësit e protokolluar te i padituri me numër 11510; ankesa e paditësit te i padituri e datës 03.06.2014; vendimi me numër të protokollit 109 i datës 04.01.2019 i të paditurit; vendimi me numër të protokollit 75 i datës 03.01.2019 i të paditurit; licenca me numër 168/14 e datës 09.09.2014 lëshuar nga i padituri në emër të paditësit; licenca me numër 2869/09 e datës 07.09.2009 e lëshuar nga i padituri në emër të paditësit; licenca me numër 119/19 e datës 04.09.2019 e lëshuar nga i padituri në emër të paditësit; procesverbali me numër serik 010591 i datës 18.07.2013 i të paditurit për paditësin; procesverbali me numër serik 010586 i datës 17.07.2013 i të paditurit për paditësin; procesverbali me numër serik 010581 i datës 16.07.2013 i të paditurit për paditësin; njoftimi për nisjet e pa mbajtura në relacionin Pejë – Istog nga stacioni i autobusëve në Pejë drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës, me numër 288 i datës

30.07.2013, si dhe ekspertiza financiare e ekspertit A.B. e datës 01.04.2022 për lëndën A.nr. 3042/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

6. Padiësi në tërësi i kundërshtoi procesverbalet e ofruara nga e Paditura, pasi sipas tij që nga viti 2013 dhe deri në mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor kurrë njëherë nuk i i janë ofruar. Gjithashtu, sipas tij ata procesverbale janë të falsifikuara të e Paditura. Lidhur me provat e administruara i Padituri nuk ka pasur asnjë vërejtje.
7. Meqenëse palët ishin pajtuar me ekspertizën financiare të ekspertit gjyqësor A.B. të datës 01.04.2022 për lëndën A.nr. 3042/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si dhe nuk kërkuar që të dëgjohet eksperti, atëherë gjykata administrimin e saj e bëri duke e lexuar në seancën e shqyrtimit kryesor.
8. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
9. Me datë 16, 17 dhe 18 korrik 2013 Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës kishte bërë inspektim në stacionin e autobusëve në Pejë, gjatë të cilëve kishte konstatuar se Padiësi pa lejen e organit që e ka lëshuar rendin e udhëtimit nuk ka mbajtur linjën e orës 13:45 sipas rendit të udhëtimit nr. 44/03/13 Pejë – Gurakoc – Istog. Këto fakt e gjykata i vërtetoi përmes procesverbaleve nr. 010591, 010586 dhe 010581 të Inspektoratit të së Paditurit.
10. Sipas kërkesë së Inspektoratit të së Paditurit, stacioni i autobusëve në Pejë përmes njoftimit 228 të datës 30.07.2013 e kishte njoftuar atë se, për datën 16, 17 dhe 18 korrik 2013 disa operatori nuk e kanë mbajtur linjën e tyre, mes tjerash ishte edhe Padiësi për rendin e udhëtimit nr. 44/03/13 për nisjen e orës 13:35 nga Peja. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes njoftimit të sapo cekur.
11. Si rezultat i gjetjeve të më sipërme, Inspektorati i të Paditurit i kishte propozuar Komisionit të Ministrisë së Infrastrukturës revokimin e udhëtimit nr. 44/03/13 në relacionin Pejë-Gurakoc-Istog-Pejë për Padiësin, ndërsa Komisioni më 12.09.2013 përmes vendimit numër 2630 e ka aprovuar kërkesën e Inspektoratit dhe ia ka revokuar Padiësit licencën për rendin e udhëtimit nr. 44/03/13 në relacionin Pejë-Gurakoc-Istog-Pejë në nisjen në ora 13:45 nga Peja. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit m e numër të protokollit 109 të datës 109 të datës 04.01.2019 të së Paditurit.

12. Padiësi më 17.10.2013 ka ushtruar ankesë kundër vendimit të cekur më lart, të cilën Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i të Padituri përmes vendimit nr. 3187 të datës 01.11.2013 e ka refuzuar si të pabazuar. Ndaj këtij vendimi, Padiësi kishte ushtruar padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, e cila përmes aktgjykimit A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016 e kishte anuluar vendimit nr. 3187 të datës 01.11.2013 dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje te i Padituri. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes aktgjykimit të sapo cekur.
13. Padiësi më 23.12.2016 i është drejtuar të Paditurit me kërkesë për ri-shqyrtimin e lëndës sipas aktgjykimit të lartcekur, por i Padituri nuk ka nxjerrë vendim sipas aktgjykimit të datës 06.10.2016. Padiësi përsëri kishte parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative për shkak të heshtjes administrativ, e cila përmes aktgjykimit A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018 e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e Padiësit dhe ka detyruar të Paditurin që në afatin prej 30 ditëve të nxjerrë aktin administrativ në rivendosje sipas kërkesës së Padiësit të datës 23.12.2016. Këto fakte gjykata i vërtetoi në bazë të aktgjykimit të cekur në këtë paragraf.
14. Meqenëse i Padituri përsëri nuk ka vepruar sipas aktgjykimit A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, atëherë Padiësi më 10.12.2018 ka paraqitur kërkesën e përsëritur për vendosje. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes parashtrësës së Padiësit, të protokolluar me numër 11510 te i Padituri.
15. Përfundimisht, i Padituri më 04.01.2019 e kishte nxjerrë vendimin e goditur me numër të protokollit 109, me të cilin e kishte refuzuar ankesën nr. 2999 të Padiësit. I Padituri kishte arsyetuar se, mes tjerash kishte konstatuar që Padiësi pa lejen e Ministrisë së Infrastrukturës brenda një muaji kalendarik nuk i ka mbajtur nisjet tri herë sipas rendit të udhëtimit nr. 44/03/13 në relacionin Pejë-Gurakoc-Istog-Pejë, me nisje nga ora 13:45 dhe kthim në orën 15:30.
16. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

17. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht kërkesëpadia e Paditësit duhet të refuzohet
18. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47, 48 dhe 134 të LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
19. Përveç kësaj, gjykata konstaton se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike lidhur me shkeljet e konstatuara nga ai. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se i Padituri gjatë inspektimeve të datave 16, 17 dhe 18 korrik 2013 përmes procesverbale përkatëse kishte konstatuar se Paditësi pa lejen e organit që e ka lëshuar rendin e udhëtimit nuk i kishte mbajtur nisjet e orës 13:45 nga Peja për udhëtimin 44/03/13, ndërsa pala i kishte nënshkruar këta procesverbale pa vërejtje. Në anën tjetër, Paditësi nuk ka sjellë asnjë provë, nga e cila do të rezultonte se gjendja faktike e konstatuar nga i Padituri është jo e saktë, gjegjësisht se i ka mbajtur udhëtimet e kontestuar ose ka pasur leje ose miratim nga organi kompetent për mos mbajtjen e rendit të udhëtimit. Gjykata rikujton se, sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon Paditësit për të vërtetuar se konstatimet e të Padituri nuk kanë qenë të sakta, përderisa në shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh diçka tjetër.
20. Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësi se asnjëherë nuk i është ofruar procesverbali nr. 010591 i datës 18.07.2013, nr. 010586 i datës 17.07.2013 dhe procesverbali nr. 010581 i datës 16.07.2013. Kjo për faktin se, ato procesverbale ishin administruara si provë gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 22.11.2022 në këtë gjykatë në lëndën KA.nr. 44/22 (e cila tani është në rivendosje), gjatë të cilit Paditësi kishte qenë prezent, si dhe ato janë të nënshkruara nga Paditësi si palë në procedurën administrative. Në këtë drejtim, për këtë gjykatë është i pabazuar edhe pretendimi i Paditësit se procesverbalet janë të falsifikuara, meqenëse fillimisht ato procesverbale i

ka nënshkruara Paditësit, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë provë, nga e cila do të mund të konstatohej se ato procesverbale janë falsifikuar.

21. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 19 para. 4 të Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor (këtu e tutje LTRr), sipas të cilit *“Operatori transportues nuk mundet ta ndërpret (pezulloj) veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në linjë sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e organit që e ka lëshuar atë rend të udhëtimit”*. Përveç kësaj, nenit 20 para. 1 nënpara. 2 i LTRr-së ka përcaktuar se *“Rendi i udhëtimit do të revokohet nga organi që e ka lëshuar atë në rastet kur: 1.2brenda një (1) muaji kalendarik pa miratimin e organit që e ka lëshuar atë nuk e mban nisjen tri (3) herë;”*. Siç kuptohet nga këto dispozita, Paditësi si operator i transportit ka qenë i obliguar që ta mbajti rendin e udhëtimit, përderisa nuk ka pasur leje nga organi që e cakton rendin e udhëtimit, ndërsa nëse nuk e mban rendin e udhëtimit për tre herë brenda një muaji kalendarik pa lejen e organit që e ka lëshuar rendin e udhëtimit, atëherë ai rend i udhëtimit revokohet. Siç rrjedh nga formulimi nenit 20 para. 1 nënpara. 1.2 i LTRr-së, revokimi i rendit të udhëtimit nuk ishte në diskrecionin e të Paditurit, por ka qenë i urdhëruara nga vet ligji.
22. Për këto arsye, meqenëse Paditësi ka dështuar të provojë se e ka mbajtur rendin e udhëtimit ose ka pasur leje nga organi kompetente për mos mbajtjen e rendit të udhëtimit, atëherë gjykata vlerëson se i Padituri ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka lënë në fuqi aktin administrativ të shkallës së parë (vendimin 2630 të datës 12.09.2013 të komisionit të Ministrisë së Infrastrukturës), me të cilin Paditësit i ishte revokuar rendi i udhëtimit nr. 44/03/13.
23. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerrë vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit

24. Në anën tjetër, meqenëse nuk është vërtetuar kundërligjshmëria e aktit administrativ të goditur, atëherë për këtë gjykatë nuk ekziston baza ligjore nga neni 26 para. 2 nënpara. 3 lidhur me nenin 46 para. 5 i LKA-së që ta detyroj të Paditurit për t'ia paguar Padiësit shumën prej 36,195.00€, meqenëse dispozitat e sapo cekura mundësojnë shpërblimin e dëmit vetëm nëse anulohet akti administrativ i goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Padiësit edhe për këtë pjesë. Në këtë drejtim, gjykata sqaron se, përderisa nuk është vërtetuar kundërligjshmëria e aktit administrativ të goditur, atëherë nuk plotësohen të gjitha kushtet për ekzistimin e dëmit në formë të fitimit të humbur (veprimi/mos veprimi, pasoja, lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit dhe pasojë edhe kundërligjshmëria e veprimit/ mosveprimit).
25. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e padiësit është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Prandaj duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.86/24

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.